

VENDIM
Nr. 899, datë 21.12.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.632, DATË 7.9.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ABAZ BEJ LUSHNJA””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 632, datë 7.9.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Lista e pasurive të prekura ndryshohet sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme të shpronësimit 10 969 849.29 (dhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë pikë njëzet e nëntë) lekë.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 10 969 849.29 (dhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë pikë njëzet e nëntë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

PËR DISA NDRYSHIME NË VKM-në 632, DATË 7.9.2016 TË PROJEKTIT “ABAZ BEJ LUSHNJA”

Nr.	Pronari		ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i ndërtimit	Sipërfaqja		Çmimi		Vlera		Vlera gjithsej Truall + Ndërtesë	Shënime
	Emër	Mbiemër				Truall m ²	Ndërtesë m ²	Truall lekë	Ndërtesë lekë	Truall lekë	Ndërtesë lekë		
1	Nuri	Beqiri	8571	18/136+1-1-2-3	Banesë	0	292		36005.227	0	10513526	10,513,526.3	Konfirmuar nr. 4941/1 prot, datë 15.6.2016
2	Nuri	Beqiri+ Bashk	8571	18/180	Truall	47	0	9709	0	456323	0	456323	Konfirmuar nr. 4941/1 prot, datë 15.6.2016
										Shuma Total		10969849.29	

